



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:021144

Datë: 19.07.2024

Numri i dokumentit: 05958095

C.nr.27/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, me gjyqtarin Jeton Krasniqi dhe bashkëpunëtorin profesional Dardan Elshani në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.P nga Komuna e Obiliqit të cilin e përfaqëson sipas autorizimit G.H.1 nga Gllogoci, kundër të paditurve –kundërshtarëve të sigurimit B.P me vendbanim në Prishtinë dhe G.H.2 nga Komuna e Gllogocit të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm H.K, duke vendosur sipas propozimit të paditëses – propozueses të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit, pas seancës së mbajtur me datë 17.07.2024, ku ish-in të pranishëm i autorizuari i propozueses së sigurimit dhe përfaqësuesi i përkohshëm i kundërshtarit të sigurimit G.H.2 e në mungesë të kundërshtarit të sigurimit B.P, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pabazuar propozimi i paditëses-propozueses së sigurimit N.P nga Komuna e Obiliqit për caktimin e masës së sigurimit me të cilin ka kërkuar që kundërshtarëve të sigurimit B.P me vendbanim në Prishtinë dhe G.H në adresë të panjohur në Spanjë, ti urdhërohet që të ndërpresin veprimet në lidhje me ndryshimin e gjendjes së ngastrës kadastrale dhe të njëjtën mos ta vënë në hipotekë, mos ta shesin apo ta ndryshojnë gjendjen ekzistuese të kësaj prone e evidentuar si ngastër me nr..., me kulturë arë e klasit të 6 në sipërfaqe prej... ha në vendin e quajtur “Rr...”, sipas fletës poseduese me nr... ZK K... me propozim që kjo ndalesë të derisa gjykata të vendosë lidhur me çështjen kryesore sipas padisë për anulimin e kontratës.

II. Procedura në këtë çështje juridike-kontestimore do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës.

III. Lidhur me shpenzimet e procedurës do të vendoset pas përfundimit të çështjes kryesore bazuar në nenin 314.2 të LPK-së.

A r s y e t i m

Paditësja-propozuesja e sigurimit N.P nga KK-Obiliq, ka parashtruar padi në gjykatë, kundër të paditurve B.P nga Prishtina dhe G.H.2 për anulimin e kontratës lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë në ngastrën kadastrale me nr..., me kulturë arë e klasit të 6 në sipërfaqe prej... ha në vendin e quajtur “Rr...”sipas fletës poseduese me nr..., ZK K...

Paditësja – propozuesja e sigurimit në propozimin e saj ka shtuar se të paditurit me rastin e kalimit të pronës në emër të tyre gjegjësisht në emër të S.H tani me emrin G.H.2 dhe se të njëjtit kanë filluar të ndërmarrin veprime për të ndërtuar një objekt aty gjegjësisht për ta ndryshuar gjendjen ekzistuese ka propozuar caktimin e masës së sigurisë.

Kundërshtarët e sigurimit përmes parashtresës me shkrim e kanë kundërshtuar propozimin për caktimin e masë së sigurisë duke theksuar se propozuesja nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën tregon se e njëjta apo paraardhësit e tij kanë qenë pronarë të palujtshmërisë lëndore, përkundrazi thirret se në një shitblerje gojore të thënë mes të paraardhësit të propozuesit dhe D.H.1 ku si blerës të cilët as njëri e as tjetri nuk kanë qenë as pronarë faktik të palujtshmërisë në fjalë. Propozueses i mungon legjitimiteti aktiv si palë në këtë çështje juridiko-civile për shkak se i njëjti me asnjë provë të vetme nuk ka vërtetuar faktin se me palujtshmërinë lëndore që është objekt i kontestit ekziston raport materialo juridik nga i cili do të rezulton çfarëdo e drejte subjektive e propozueses. Kundërshtari i sigurimit është pronarë faktik dhe juridik i parcelës së blerë nga B.P ku këtij të fundit pronën në fjalë e ka blerë S.H ku dhe të njëjtën provë ia ka lënë babai i tij tani i ndjerë P.H dhe kontrata është lidhur me datë... me shenjë Vr.nr... por e njëjta për arsye neglizhence dhe mosdije ka mbetur ende pa u bartur në librat kadastral, andaj kanë propozuar që propozimi i propozueses së sigurimit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata duke vepruar, në kuptim të dispozitave të LPK- së, ka caktuar seancën dëgjimore me datën: 17.07.2024, lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, në të cilën seancë kanë marrë pjesë i autorizuari i propozueses së sigurimit dhe vet propozuesja si dhe përfaqësuesi i përkohshëm i kundërshtarit të sigurimit G.H.2, ndërsa nuk ka marrë pjesë kundërshtari i sigurimit B.P edhe pse i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt por mungesën e ka arsyetuar. Pastaj gjykata me propozimin e të autorizuarës së propozueses duke u bazuar në nenin 423.4 të LPK-së ka marrë aktvendim dhe seancën e ka mbajtur në mungesë të kundërshtarit të sigurimit B.P.

I autorizuari i paditëses – propozueses së sigurimit gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë propozimit për caktimin e masës së sigurisë duke konsideruar se në mënyrë kumulative plotësohen kushtet nga neni 297 pika a) dhe b), deri ne nenin 300 të LPK-së, pasi që është fakt i pa mohueshëm që diku në vitin 1991, D.H.1 njëherit baba i propozueses pasi që me vëllain D.H.2 nga familja Xh... kishte blerë palujtshmerinë që është objekt i kësaj çështje por për shkak të rrethanave të asaj kohe të cilat janë te njohura botërisht i njëjti kishte kërkuar që kjo pronë të bartet në emër të B.P, tani kundër propozues me qëllim që ky i fundit pa ndonjë veprim tjetër ta barte tek trashëgimtarja e tani të ndjerit D.H.2. Mirëpo kundërshtari i sigurimit në mënyrë të fshehtë duke mos e mbajtur fjalën lidhur me këtë çështje, të njëjtën pronë e bartë te S.H tani me emrin G.H.2 edhe pse paraprakisht e ka ditur që nuk mund të bëjë një gjë të tillë, aq më tepër ky i fundit është duke marre veprime konkrete për të ndryshuar gjendjen ekzistuese gjegjësisht ka filluar ta ndryshoj gjendjen e terrenit dhe të ndërtoj aty, andaj konsideroj se edhe e drejta subjektive e propozueses mbi atë pronë por edhe ndryshimi i gjendjes faktike janë duke ndodhur dhe siç parashihet me nenet e cekura me lartë, konsideroj se janë plotësuar kushtet për caktimin e masës.

Propozuesja në seancën dëgjimore ka deklaruar se kundërshtari i sigurimit S.H (G.H.2) e ka zënë një pjesë të ngastrës për të cilën e kemi propozuar masën e sigurisë si dhe në ngastrën e tij ku e ka ndërtuar një autoservis dhe atë qe 3 vite, duke shtuar se në servis punon djali i vëllaut të tij.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i propozueses së sigurimit ka deklaruar se me zhvillimin e kësaj procedure dhe administrimin e provave konsideroj se pa mëdyshje u vërtetua se paditësja-propozuesja e sigurimit është e bija e të ndjerit D.H.2, i cili në vitet 1990 për shkak të rrethanave duke patur besimin tek B.P të njëjtit ia ka besuar që prona e tij të regjistrohet në emër të tani kundërshtarit të sigurimit B.P. Pasi që z.D.H.2 ka ndërruar jetë, i ndjeri ka lënë vetëm 2 vajza e këto të fundit janë martuar në fshatrat jashtë ku gjendet paluitshmëria. B.P ka shfrytëzuar gjendjen e rënde, mungesën e prezencës së trashëgimtarëve të të ndjerit D... dhe me keqbesim ndoshta ka vënë në lajthim edhe kundërshtarin e sigurimit S.H (G.H.2) dhe të njëjtën pronë ia ka shitur, e po ashtu edhe ka marre veprimet administrative lidhur me kalimin e kësaj prone edhe në aspektin juridik. Po ashtu në atë pronë është duke u zhvilluar biznes si autoservis i automjeteve me tendencë që çdo ditë të rritet biznesi , ndërtohen pjesë tjera që e zgjerojnë objektin, e krejt këtë pa baze ligjore, andaj gjykatës i ka propozuar ta aprovoj propozimin për caktimin e masës si mundësi e vetme për të mbrojtur të drejtat themelore të propozueses e të cilat iu kanë mohuar duke e shfrytëzuar situatën e cekur si më lartë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës ka theksuar se do të deklarohej dhe do ti precizojmë kur të vendoset rreth çështjen kryesore.

Përfaqësuesi i përkohshëm i kundërshtarit të sigurimit gjatë seancës dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet edhe më tutje pranë përgjigjejes në formë të kundërshtimit ndaj propozimit për masë të sigurisë të ushtruar nga S.H tash (G.H.2) dhe gjithashtu e kundërshtojmë propozimin për masën e sigurimit për parcelën që është lëndë kontestuese e shqyrtimit të kësaj gjykate me numër... për faktin se me asnjë provë të vetme paditësja tash propozuesja e masës së sigurimit nuk argumenton para gjykate se është e nevojshme dhe e domosdoshme caktimi i saj pasi që gjendja e parcelës është e njëjtë qe shumë vite dhe nuk është rrezik që ajo të ndryshoj, të tjetërsohet apo të priset struktura e saj. Po ashtu nga shqyrtimi i shkresave të lëndës nuk figuron me asnjë provë se parcela kontestuese ka qenë ndonjëherë në emër të babait të paditësës-propozueses, andaj gjykatës i ka propozuar që në këtë fazë të procedurës ta refuzoj propozimin si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për një seancë të shtyrë dhe një të mbajtur.

Gjykata shqyrtoi me kujdes propozimin për masën e sigurimit dhe pas analizimit të provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditësë-propozueses së sigurimit për caktimin e masës së sigurisë, është i pa bazuar.

Me nenin 297 të LPK-së, në mënyrë decidive ceket se “Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”. Po ashtu me nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit, ndërsa me nenin 304.3 të LPK-së, është përcaktuar se, mes tjerash, “propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që këto “mjete provuese t’ia bashkëngjisë propozimit”.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartpërmendura, erdhi në përfundim se propozimi i palës paditëse-propozueses së sigurimit për caktimin e masës së sigurimit në këtë fazë të procedurës është i pabazuar. Kjo për arsye se duke u nisur nga propozimi i palës paditëse-propozueses së sigurimit me të cilin ka kërkuar që “kundërshtarëve të sigurimit B.P me vendbanim në Prishtinë dhe G.H.2 tani në adresë të panjohur në Spanjë, ti urdhërohet që të ndërpresin veprimet në lidhje me ndryshimin e gjendjes së ngastrës kadastrale dhe të njëjtën mos ta vënë në hipotekë, mos ta shesin apo ta ndryshojnë gjendjen ekzistuese të kësaj prone e evidentuar si ngastër me nr..., me kulturë arë e klasit të 6 në sipërfaqe prej... ha në vendin e quajtur “Rr...” sipas fletës poseduese me nr..., ZK K... me propozim që kjo ndalesë të derisa gjykata të vendosë lidhur me çështjen kryesore sipas padisë për anulimin e kontratës”, del se propozimi i propozueses së sigurimit nuk i plotëson kushtet kumulative për caktimin e masës së sigurisë për arsye se lidhur me kushtin nga neni 297.1, pika a) e LPK-së.

Në rastin konkret paditësja – propozuesja e sigurimit nuk ka dëshmuar me asnjë provë qoftë vendim të mëhershëm të gjykatës apo të ndonjë organi administrativ, testament, kontratë, ndonjë dokument përbarimor, respektivisht ndonjë titulli tjetër juridik që të provoj të drejtën subjektive të saj lidhur me ngastrën... më gjerësisht të cekur si në dispozitiv. Gjykata gjenë se paditësja – propozuesja e sigurimit për shkak se nuk ka arritur për të provuar të drejtën subjektive të saj e njëjta nuk e ka plotësuar kushtin e parë nga neni 297 par.1 pika a) e LPK-së.

Përveç kësaj paditësja-propozuesja e sigurimit me asnjë provë nuk ka arritur që të vërtetoj se kundërshtari i sigurimit G.H.2 të ketë marrë ndonjë veprim në drejtim të ndryshimit të gjendjes ekzistuese qoft me ndërtim të ndonjë objekti apo të tjetërsimit të ngastrës së lartcekur në ndonjë formë apo futjes në hipotekë të saj. Pretendimi i të autorizuarit të paditëses- propozueses së sigurimit se i njëjti është duke ndërtuar objekt ndërtimor dhe është duke e ndryshuar gjendjen ekzistuese gjykata nuk ia fali besimin pasi që i njëjti gjykatës nuk ia ka dorëzuar asnjë provë për ta vërtetuar këtë fakt edhe pse barra e provës i takon paditësit por edhe vet propozuesja e sigurimit në seancë ka deklaruar se në ngastrën që është objekt kontesti është i ndërtuar një servis që para 3 vitesh që i bie se objekti ka qenë i ndërtuar para ushtrimit të padisë dhe propozimit të masës së sigurisë e cila në gjykatë është ushtruar me datë 24.01.2023. Andaj në mungesë të provave paditësja nuk ka arritur të plotësoj as kushtin e dytë nga neni 297 par.1, pika b) e LPK-së se ekziston rreziku që pala kundërshtarë do të mund të bënte tjetërsimin e pasurës së vet, ta fsheh atë, ta vë në ngarkim qoftë me peng apo nën hipotekë etj.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e refuzoi propozimin e palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit, pasi vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore në mënyrë kumulative të parapara me nenin 297.1 pika a) dhe b) e LPK-së, për tu caktuar një masë e tillë.

Gjykata ka vendosur lidhur me shpenzimet si në pikën III të dispozitivit të aktvendimit duke u bazuar në nenin 314.2 të LPK-së ku është paraparë se “*Po që se propozimi për caktimin e masës së sigurimit paraqitet gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore apo të ndonjë procedure tjetër gjyqësore, gjykata kompetente për vendosje mbi kërkesëpadinë, apo mbi kërkesën tjetër, vendosë se cili i bartë shpenzimet e caktimit dhe zbatimit të masës së sigurimit*”.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 387.1 pika (1), lidhur me nenin 142.5 të LPK-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINËM, Dega në Glllogoc
C.nr.27/2023, datë 17.07.2024**

Gjyqtari

Jeton Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej (7) ditësh, pas marrjes se të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, nëpërmes kësaj gjykate.